



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

---

## RAPORT

### I

## MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS PËR VIZITËN NË QENDRËN E PARABURGIMIT NË GJILAN

**Për:** Znj. Albulena Haxhiu, ministre  
Ministria e Drejtësisë

**Kopje:** Znj. Duda Balje, kryetare  
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe  
Peticione

Z. Habit Hajredinaj, drejtor  
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Z. Ali Gashi, ushtrues detyre i drejtorit të përgjithshëm  
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Milazim Gjocaj, drejtor  
Departamenti për Shëndetësinë në Burgje

Z. Xhevdet Manqastena, drejtor  
Qendra e Paraburgimit në Gjilan

Prishtinë, më 15 dhjetor 2021

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (më tej: MKPT) i Avokatit të Popullit, më 3 nëntor 2021 vizitoi Qendrën e Paraburgimit në Gjilan (më vijim: QPGj).

### **Qëllimi i vizitës**

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat themelore të të burgosurve.

### **Bashkëpunimi me MKPT-në gjatë vizitës**

1. Gjatë vizitës së MKPT-së në QPGj, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës (tani e tutje: ShKK) dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (më vijim: DShB) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat e QPGj-së, iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me personat e dënuar dhe të paraburgosur pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe shëndetësorë.
2. Megjithatë, drejtori i QPGj-së vlerësoi se vizita e MKPT-së duhet të paralajmërohej paraprakisht. Pas sqarimeve të nevojshme të bazuara në legjislacionin në fuqi, vizita u zhvillua në pajtim të plotë me Ligjin për Avokatin e Popullit. Përmes këtij raporti, MKPT-ja ua rikujton të gjitha autoriteteve kompetente se neni 17, paragrafi 2.1, i Ligjit për Avokatin e Popullit, përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e MKPT-së, ku ndër të tjera shprehimisht përcakton: *“Të vizitohet rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.”*

### **Keqtrajtimi**

3. MKPT-ja gjatë vizitës në QPGj ka intervistuar një numër të burgosurish dhe nuk mori asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. Po ashtu MKPT-ja nuk mori asnjë ankesë lidhur me sjelljet e zyrtarëve korrektues apo të personelit shëndetësor, të cilat do të përbënin trajtim që nuk është në pajtim me respektimin e dinjitetit të njeriut të të burgosurve. Gjatë vizitës është vërejtur komunikim interaktiv dhe miqësor ndërmjet personelit korrektues dhe të burgosurve.

### **Kushtet e akomodimit**

4. Në ditën e vizitës, në QPGj ishin të akomoduar 210 të burgosur, nga ta 186 të paraburgosur dhe 24 të dënuar. Kapaciteti zyrtar i QPGj-së është për 300 persona, QPGj-ja nuk përballet me mbipopullim. MKPT-ja ka vërejtur se të dënuarit dhe të paraburgosurit janë të ndarë në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (më tej: LESP) dhe me aktet e tjera relevante ndërkombëtare.<sup>1</sup> Qelitë ku vendosen të burgosurit janë në pajtim me LESP-në dhe me Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (në vijim: KPT).

<sup>1</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 33, paragrafi 7. Rregullat e Mandelës, Rregulli numër 11, pika b). Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 18.8. Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 10.2, pika b).

5. Qelitë ku akomodohen të burgosurit kanë ndriçim të mjaftueshëm, nuk kanë lagështi dhe po ashtu kanë ngrohje adekuate dhe pastërti. Në qeli janë të vendosur nga një ose dy të burgosur. Pranuar ankesa nga të burgosurit për shtretër të papërshtatshëm, pasi ishin të dizajnuar në dy kate dhe personat e vendosur sipër nuk kishin kufizim anash (nuk kishin mbrojtje) dhe ishin të lartë, disa prej tyre vendosnin dyshekun në dysheme.
6. MKPT-ja ka vërejtur se të burgosurve u mungojnë hapësira (dollarë) adekuate për të vendosur gjësendet e tyre, si dhe mungonte inventarizimi, si: tavolinat e karriget.
7. Nga të burgosurit e akomoduar në katet më të larta, MKPT-ja mori ankesa për mungesë të shtypjes së ujit dhe të ujit të ngrohtë. Sipas drejtorit, problemi synohet të rregullohet përmes planit për investime kapitale, duke instaluar bojlerë të mëdhenj.

### **Marrëdhëniet ndërmjet të burgosurve**

8. MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur një klimë mjaft pozitive ndërmjet të burgosurve. Në pjesën ku akomodohen të dënuarit, janë të vendosur edhe të dënuar të përkatësisë etnike serbe, të cilët nuk shprehën asnjë ankesë lidhur me trajtimin dhe marrëdhëniet me të burgosurit e tjerë.

### **Ushqimi**

9. LESP-ja përcakton të drejtën e të burgosurve për ushqim të përshtatshëm, për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tyre, me tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të jenë të llojllojshme. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'u përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, aq sa është e mundur, kërkesave të tij fetare dhe kulturore.<sup>2</sup>
10. MKPT-ja gjatë vizitës nuk ka marrë ankesa sa u përket cilësisë dhe sasisë së ushqimit. Megjithatë, MKPT-ja ka vërejtur se menyuja dietale është e varfër, pavarësisht përpjekjeve të QPGj-së për të siguruar ushqimin adekuat dietal sipas rekomandimit të mjekut. MKPT-ja rithekson, si edhe në raportet e tjera, obligimin e autoriteteve kompetente për të siguruar furnizime të pandërprera me ushqim dietal sipas rekomandimeve të mjekut.<sup>3</sup>

### **Kuzhina**

11. Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejtiti se kushtet higjienike në kuzhinë janë në nivelin e duhur, kuzhina është e pajisur me pajisjet e nevojshme për ta kryer punën në përgatitjen e ushqimit, përveç një kazani të thellë, i cili ishte jashtë funksionit. Gjatë vizitës në kuzhinë MKPT-ja ka vërejtur se janë të angazhuar në punë 4 kuzhinierë dhe 10 të burgosur të angazhuar në punë të tjera ndihmëse në kuzhinë.
12. Të angazhuarit në punë, përfshirë këtu edhe të burgosurit, janë në pritje të marrjes së librezave sanitare. MKPT-ja konstatoi se depoja ku mbahet ushqimi afatgjatë ishte në gjendje të mirë dhe posedonte kushtet që nevojiten për ruajtje të ushqimit dhe po ashtu nuk ka lagështi. Sipas personelit të kuzhinës, mungon uniforma adekuate dhe mbathjet për personelin dhe për të angazhuarit në kuzhinë. MKPT-ja inkurajon institucionin që të kujdeset për kushtet e punës së stafit të kuzhinës.

<sup>2</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 1.

<sup>3</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 40.2 shprehimisht thekson: "Ushqimi dhe uji i përshtatshëm nga aspekti mjekësor, zbatimi i tabelave dietale dhe përgatitja e shujtave mbikëqyret rregullisht nga shërbimi mjekësor në secilin institucion korrektues." Rregullat e Mandelës, Rregulli numër 22.

## Regjimi

13. Sipas drejtorit të QPGj-së, 18 të dënuar dhe 9 të paraburgosur janë të angazhuar në punë. Të paraburgosurit dhe të dënuarit mund të dalin në ajrosje (shëtitje) dy herë në ditë në kohëzgjatje prej 1 ore, gjë që është në pajtim me LESP-në dhe me aktet e tjera relevante ndërkombëtare.<sup>4</sup> Përgjithësisht ata angazhohen në punë pastrimi, në kuzhinë, në lavanteri dhe në kryejnë e punëve të tjera të caktuara të përkohshme.
14. Përndryshe, edhe gjatë kësaj vizite MKPT-ja vërejtë se në QPGj nuk ka asnjë aktivitet rekreativ, kulturor, sportiv. LESP-ja dhe aktet e tjera ndërkombëtare, relevante për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve përcaktojnë obligimet e autoriteteve për të siguruar aktivitete të mirëfillta dhe programe rehabilitimi për të burgosurit.<sup>5</sup>
15. Sipas informatave nga punëtorët socialë, kanë përfunduar trajnimin 10-ditor për trajnerë me programin EQUIP, me titull: “*Menaxhimi i zemërimit*”. Pastaj trajnimi është mbajtur me 5 të burgosur, prej të gjitha kategorive të të burgosurve. Trajnimi është udhëhequr nga punëtorët socialë dhe të dënuarve u janë ndarë certifikata. Trajnimi do të vazhdojë edhe me të gjithë të dënuarit e tjerë.
16. Po ashtu, zyrtarët socialë kanë ndjekur një trajnim dyjavor, me temën: “*Intervistimi Motivues*”. Trajnimi ka për qëllim që zyrtarët socialë të pajisen me aftësi për përdorimin e teknikave të intervistimit motivues gjatë punës me të burgosurit.
17. MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se punohej në rregullimin e fushave sportive, dhe dy shëtitore shtesë janë duke i bërë, gjë që do të mundësonte angazhimin më të madh të të burgosurve jashtë qelisë. MKPT-ja do të vazhdojë ta ndjekë angazhimin e QPGj-së në realizimin sa më të shpejtë të mundësive për aktivitete sportive, rekreative për të burgosurit.
18. QPGj-ja ka edhe një bibliotekë e cila posedon libra të ndryshme në gjuhën shqipe. Biblioteka ekziston si një prej aktiviteteve dhe rekreacionit që të burgosurit e shfrytëzojnë. Është e pasuruar me tituj, gjithashtu edhe familjarët u sjellin libra.

## Kujdesi shëndetësor

19. Sa i përket personelit mjekësor, në përbërje të njësisë shëndetësore janë një mjek me orar të rregullt të punës (orar i koordinuar, meqenëse mjeku është në specializim) dhe në thirrje, 5 infermierë (4+1 kryeinfermierja) të rregullt, ku infermierët punojnë me ndërime 24 orësh, ndërsa kryeinfermierja me orar 8:00-16:00. Sa i përket konsultimeve, stomatologu, pulmologu dhe psikiatri ofrojnë shërbimet e tyre një herë në javë. Shërbimet tjera e kryhen në spitalin regional të Gjilanit dhe në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK).

---

<sup>4</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 23. Rregullat Evropiane të Burgjeve, neni 27.1. Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, paragrafi 48, publikuar në vitin 2015. Sipas nenit 37 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të dënuarit kanë të drejtë në së paku dy orë shëtitje.

<sup>5</sup> Neni 88.1 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale: “*Aktivitetet kulturore, rekreative dhe sportive, si dhe aktivitetet tjera që synojnë zhvillimin e personalitetit të personit të dënuar organizohen brenda institucioneve korrektuese me ndihmën e subjekteve publike dhe private të interesuara për ri-integrimin e personave të dënuar në shoqëri.*” Rregullat e Mandelës, Rregulli 104. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 11-të i Përgjithshëm, paragrafi 32, publikuar në vitin 2000: “*Aktivitetet të cilat u sigurohen të burgosurve duhet të jenë sa më të llojlojshme që të jetë e mundur (edukim, sport, punë të vlerës trajnuese).*” Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, pjesë nga Raporti i 3-të i Përgjithshëm, paragrafi 43 [CPT/Inf (93) 12].

Rregullat Evropiane të Burgjeve, 25.1: “*Regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit duhet të ofrojë një program të balancuar të aktiviteteve rehabilituese.*”

20. Kurse një psikologe është me orar të rregullt, por momentalisht është në pushim të lindjes, kështu që është duke u zëvendësuar nga një psikolog tjetër, i cili punon një herë në javë. Prania e të burgosurve me sëmundje mendore vazhdon të jetë sfidë për qendrat e paraburgimit dhe për ato korrektuese, për shkak të mungesës së kapaciteteve për t'i akomoduar të burgosurit e kësaj kategorie në institucione përkatëse shëndetësore. MKPT-ja konsideron se duke pasur parasysh numrin e të burgosurve në QPGj, si dhe rasteve me probleme mendore, nuk mjafton angazhimi i psikologut vetëm një herë në javë.
21. Sa i përket infrastrukturës dhe pajisjeve në dispozicion, gjendja është në nivel të kënaqshëm. Hapësirat e vizituara ku ofrohen shërbimet mjekësore, në përgjithësi, janë të një standardi të mirë. MKPT-ja gjatë vizitës nuk ka marrë asnjë ankesë nga të burgosurit lidhur me trajtimin shëndetësor në QPGj.
22. MKPT-ja ka vërejtur se njësia shëndetësore posedon protokollet si në vijim: Protokollin e vetëlëndimeve; i lëndimeve trupore; për tentim-vetëvrasjet; i grevës së urisë; i abuzimeve seksuale; për vdekjet në burg. Psikologu, psikiatri dhe mjeku posedojnë regjistrat e veçantë të punës me pacientë.

### **Rëndësia e kontrolleve mjekësore**

23. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (më tutje: KPT), në raportet për shtete dhe në raportet e përgjithshme vazhdimisht ka theksuar rëndësinë esenciale që kanë kontrollet mjekësore, sidomos në rastet e të burgosurve apo të të paraburgosurve të sapopranuar jo vetëm për identifikimin e sëmundjeve infektive dhe parandalimin e vetëvrasjeve, por edhe nëpërmjet kontributit i cili jepet në aspektin e parandalimit të torturës përmes evidentimit të duhur të lëndimeve.<sup>6</sup>
24. Bazuar në Praktikën Standarde të Veprimit dhe LESP-së, të burgosurit e sapopranuar i nënshtrohen kontrollit mjekësor brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i pranimit në QPGj, me ç' rast hapet dosja mjekësore dhe evidentohen problemet shëndetësore dhe plagët apo lëndimet eventuale të pranuar para arritjes në QPGj. MKPT-ja, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe në intervistat me të burgosurit, ka vërejtur se njësia shëndetësore në QPGj vepron në pajtim me aktet e lartpërmendura.

### **Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore**

25. Sa i përket konfidencialitetit të shërbimeve mjekësore, MKPT-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe me personelin shëndetësor, konstaton se këto shërbime jepen nën kushte të cilat respektojnë konfidencialitetin, respektivisht jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues, përveç në raste kur prania e tyre kërkohet nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor.

### **Kontakti me botën e jashtme**

26. Legjislacioni në fuqi<sup>7</sup>, në rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar të korrespondencës (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat minimum një orë, si dhe për

<sup>6</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, publikuar në vitin 2016, paragrafi 62, në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>, (6.3.2018). Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, raporti i 26-të i Përgjithshëm, paragrafi 72, në: <https://rm.coe.int/168070d0c8>, (6.3.2018).

<sup>7</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë telefonata.

27. Lidhur me telefonatat, Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese<sup>8</sup> përcakton se i dënuari ka të drejtë në biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me personat e tjerë. Sipas këtij udhëzimi, biseda telefonike e personit të dënuar dhe të paraburgosur nuk mund të jetë më e gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë minuta).
28. Gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 dhe bazuar në masat e ndërmarra nga autoritetet kompetente, pati kufizime të kontakteve me botën e jashtme. Këto kufizime u kompensuan duke ua ofruar të burgosurve mundësinë për të komunikuar me SYKPE. MKPT-ja u njoftua se momentalisht këto kufizime janë reduktuar dhe SKYPE u lejohet vetëm të burgosurve të cilët nuk kanë vizita familjare.
29. MKPT-ja mori ankesa nga shtetasit e huaj të cilët kanë vështirësi apo nuk mund të kontaktojnë fare me familjet e tyre, për shkak se në disa vende nuk funksionojnë lidhjet telefonike. Po ashtu, problem përbën edhe komunikimi me të burgosurit, të cilët janë shtetas të huaj dhe nuk flasin gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës apo gjuhët më të shpeshta.
30. Kontakti me botën e jashtme për të burgosurit garantohet me LESP, me Kodin e Procedurës Penale dhe me aktet e tjera relevante nënligjore, si dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
31. Në këtë drejtim, MKPT-ja vlerëson se autoritetet kompetente duhet t'i rrisin përpjekjet për t'ua mundësuar të burgosurve në fjalë kontaktet me familjet e tyre për aq sa një gjë e tillë është e mundur dhe nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi.
32. Në rastin e të paraburgosurve, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita "brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit" bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij. Më tej Kodi përcakton se korrespondenca dhe vizitat e tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të paraburgosurit lidhur me këtë të drejtë.
33. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund t'i vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, të gjyqtarit të vetëm gjykues apo të kryetarit të trupit gjykues ose të personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit.
34. Në rastin e shtetasve të huaj, atyre u ofrohet mundësia që me shkrim ose me gojë të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike apo me zyrën përkatëse të shtetit shtetësinë e të cilit e ka ai.<sup>9</sup> Gjatë vizitës, MKPT-ja e ka intervistuar një shtetas të Republikës së Maqedonisë, i cili nuk pati ankesa lidhur me gëzimin e kësaj të drejte dhe të të drejtave të tjera të personave të paraburgosur.

<sup>8</sup> Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 54.

<sup>9</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 33, paragrafi 1.

35. Po ashtu, MKPT-ja ka vizituar edhe ambientet ku pranohen vizitat familjare për të dënuarit dhe për të paraburgosurit, si dhe dhomat ku të burgosurit mund të takohen me avokatin e tyre mbrojtës. Vizitat për të dënuarit janë të tipit të lirë, të pajisura me tavolina dhe karrige. Në rastin e të paraburgosurve, vizitat janë të tipit të mbyllur dhe nuk është i mundur kontakti fizik. Lidhur me këtë çështje, MKPT-ja, në Raportin me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, në vitin 2019<sup>10</sup>, ka theksuar si në vijim:

*“MKPT-ja, inkurajon autoritetet kompetente që t’i shqyrtojnë mundësitë që këto vizita të zhvillohen në kushte më të hapura dhe duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut individual që përbën i burgosuri i caktuar.”<sup>11</sup>*

36. Vizitat në kushte të tillë, kur nuk është i mundur kontakti fizik, mund të përbëjnë problem serioz për mirëqenien e fëmijëve të cilët i vizitojnë të burgosurit në kuadër të vizitave familjare.

### **Çështje të ndërlidhura me sigurinë**

37. MKPT-ja u njoftua nga drejtori se të gjitha pavijonet janë të pajisura me kamera të sigurisë të cilat, sipas KPT, përbëjnë një nga garancitë për mbrojtje nga keqtrajtimi.<sup>12</sup> Gjithashtu edhe hapësirat jashtë objektit të burgut mbulohen nga kamerat e sigurisë, përveç njërës kamerë mbrapa objektit, e cila nuk është funksionale. Megjithatë, sipas drejtorit, së fundmi është bërë kërkesë për pajisje me kamera të reja.

38. MKPT-ja përmes raportit të publikuar më 19 mars 2018 si dhe Letrës me rekomandime drejtuar autoriteteve në dhjetor 2019, u ka dërguar rekomandimin autoriteteve: *“Të asfaltohet pjesa e rrugës së paasfaltuar, e cila mund të paraqesë vështirësi serioze gjatë stinës së dimrit dhe në kushte të reshjeve atmosferike për kryerjen e punës së QPGj-së, në pajtim me LESP-në.”* MKPT-ja gjatë vizitës së fundit ka vërejtur se gjendja mbetet e njëjtë dhe kërkon nga autoritetet e burgut të na njoftojnë lidhur me veprimet e tyre për këtë çështje.

### **Procedura e parashtrimit të ankesave**

39. Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garancia themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda burgut apo brenda qendrës së paraburgimit ku akomodohen dhe që në mënyrë konfidenciale t’u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.

40. Neni 91 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t’i drejtohen me ankesë apo me lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t’i drejtohet një

<sup>10</sup> Për më shumë, shiko raportin e MKPT-së për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë në vitin 2019, në: <https://oik-rks.org/2019/11/25/raport-me-rekomandimi-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-prishtine/>.

<sup>11</sup> Ky rekomandim u bazua edhe në Raportin e KPT-së për vizitën në Ukrainë, ku KPT-ja lidhur me këtë çështje u rekomandoi autoriteteve ukrainase, si në vijim: *“...që rregulloret relevante të ndryshohen ashtu që të gjithë të burgosurve, përfshirë edhe ata të paraburgosur, t’u mundësohet të pranojnë vizita në kushte të arsyeshme dhe të hapura, ndërsa përdorimi i objekteve të mbyllura për vizita do të duhej të ishte më shumë përjashtim sesa rregull.”* Më tej KPT-ja theksoi se vizitat e tipit të mbyllur duhet të jenë gjithmonë të bazuara dhe të arsyetuara mirë, si dhe të bazuara në vlerësimin individual të rrezikut potencial, të cilin e paraqet i burgosuri i caktuar.

<sup>12</sup> KPT, raporti për vizitën në Irlandë në vitin 2010, paragrafi 18.

autoriteti më të lartë, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe ministri i Drejtësisë.<sup>13</sup>

41. MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve në QPGj janë kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP). Kutitë e ankesave të vendosura nga IAP-ja mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.
42. MKPT-ja po ashtu ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve, në rast se ata kanë ankesa lidhur me shërbimet e ofruara mjekësore, është një kuti e ankesave e vendosur nga DShB-ja, e cila është e vendosur në objektin e njësisë shëndetësore dhe të cilën mund ta hapë vetëm zyrtari i caktuar nga DShB-ja.
43. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa nga të paraburgosurit dhe të dënuarit lidhur me çështjen e parashtrimit të ankesave apo për vonesa për t'i shqyrtuar ankesat e tyre brenda afatit ligjor.

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të MKPT-së gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

### REKOMANDON

#### Ministrisë së Drejtësisë:

- **MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të sigurohen më shumë aktivitete kulturore, sportive dhe programe për rehabilitim dhe për risocializim të të burgosurve.**
- **Të bëhen përpjekje për të gjetur mënyrën adekuate në pajtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës për t'ua mundësuar shtetasve të huaj kontaktet me familjet e tyre, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj  
Avokat i Popullit

<sup>13</sup> Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: “Në ankimin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën me shkrim.”